



Prishtinë, 28 mars 2019
Kodi i ZRRE: V_1125_2019

Bordi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë,

Duke u bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, Nenit 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5, Nenit 25, Nenit 26 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, Nenit 46 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 Nenit 47 paragrafi 3 nënparagrafi 3.3 dhe Nenit 48 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 16 dhe 22 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085);
- Rregulla për vendosjen e të hyrave të lejuara maksimale të operatorit të sistemit të transmetimit dhe tregut (Rregulla për Të Hyrat e OST/OT-së);
- Vendimin e ZRRE-së nr. V_1028_2018, lidhur me të hyrat e lejuara maksimale për periudhën e dytë rregullative 2018-2022, për Operatorin e Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (OST/OT); dhe
- Aplikacionin e Operatorit Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (KOSTT SH.A.), për të Hyrat e Lejuara Maksimale, të dorëzuar me datën 23 janar 2019 në ZRRE,

në seancën e mbajtur më 28 mars 2019 nxori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHEN TË HYRAT E LEJUARA MAKSIMALE (HLM në tekstin e mëtejme MAR) që do të mbulohen nga Operatorit Sistemit të Transmetimit dhe Tregut-KOSTT SH.A. përmes tarifave për shfrytëzimin e sistemit të transmetimit dhe tregut për vitin relevant tarifor 1 prill 2019 - 31 mars 2020.**
- II. Të Hyrat e Lejuara Maksimale që do të mbulohen nga KOSTT-i për vitin relevant tarifor 1 prill 2019 - 31 mars 2020 do të jenë 54,196,494 euro.**
- III. Të Hyrat e Lejuara Maksimale për KOSTT do t'i nënshtrohen Procesit të Përshtatjeve të Rregullta vjetore, sipas Rregullës për Të Hyrat e OST/OT-së të nxjerr nga ZRRE.**


- IV. Operatori Sistemit të Transmetimit dhe Tregut-KOSTT SH.A., duhet t'i përgatis dhe dorëzoj për aprovim në ZRRE tarifat për shfrytëzim të sistemit të transmetimit/operatorit të tregut të përcaktuar me MAR-in sipas këtij Vendimi.
- V. Tarifat e propozuara nga OST/OT duhet të jenë në përputhje me Metodologjinë e Përcaktimit të Tarifave të Operatorit të Sistemit të Transmetimit, Operimit të Sistemit dhe operimit të Tregut dhe Metodologjia e Taksave të Kycjes në Rrjetin e Transmetimit, të aprovuara nga ZRRE.


ARSYETIM


- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) më datë 08 dhjetor 2018 ka iniciuar azhurnimet vjetore të Të Hyrave të Lejuara Maksimale për KOSTT.
 - ZRRE më datë 23 janar 2019 nga KOSTT ka pranuar aplikacionin për aprovim të Hyrave të Lejuara Maksimale.
 - ZRRE për përcaktimin e të Hyrave të Lejuara Maksimale (MAR) ka marrë parasysh dokumentet nxjerra dhe të publikuara në faqen zyrtare të ZRRE-së:
 - Raport Konsultativ - Përshatjet vjetore të Të Hyrave të Lejuara Maksimale për KOSTT (Prill 2019 - mars 2020), i publikuar më 22 shkurt 2019; dhe
 - Raport përfundimtar për Të Hyrat e Lejuara Maksimale të OST/OT-së, Përgjigjet ndaj Komenteve (prill 2019 - mars 2020).
 - Bordi i Rregullatorit pas vlerësimit dhe analizimit të raporteve relevante dhe pas shqyrtimit të komenteve të pranuar nga palët, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrjet të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- VI. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- VII. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të zbatohet nga operatori i sistemit të transmetimit dhe operatori i tregut duke filluar nga 1 prill 2019, dhe i njëjti do të publikohet në ueb faqen zyrtare të ZRRE-së.


Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data e pranimit të vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhet e fundit.

Bordi i ZRRE-së:


Arsim Janova, u.d. kryesues


Besim Sejfiqaj, anëtar


Selman Hoti, anëtar


Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Operatorit Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (KOSTT), dhe
- Arkivit të ZRRE-së.